

UDHËZIM
Nr. 26, datë 7.12.2020

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 17, DATË 3.8.2016, “PËR PROCEDURAT DHE KRITERET PËR NJOHJEN DHE NJËSIMIN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, TË DIPLOMAVE, CERTIFIKATAVE, GRADAVE SHKENCORE DHE TITUJVE AKADEMIKË TË LËSHUAR NGA INSTITUCIONET E HUAJA TË ARSIMIT TË LARTË DHE INSTITUCIONE TË TJERA TË AUTORIZUARA, JASHTË VENDIT”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të nenit 91, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

1. Në pikën 5.4, të kreut IV, të udhëzimit nr. 17, datë 3.8.2016, bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

“5.4 Për njohjen e gradave shkencore dhe titujve akademikë ngrihen me urdhër të ministrit përgjegjës për arsim, komisione *ad hoc*, sipas fushave përkatëse me pedagogë ekspertë të fushës së kategorisë “profesor”, të cilat mblidhen në varësi të numrit të aplikimeve dhe shqyrtojnë dosjet përkatëse. Kryetar i komisionit është ministri përgjegjës për arsimin. Komisioni përkatës nuk mund të mblidhet më vonë se 30 ditë kalendarike pas njoftimit për shqyrtimin e një aplikimi. Në përfundim të procedurave të shqyrtimit, komisioni firmos procesverbalin dhe ministri përgjegjës për arsimin lëshon vërtetimin për njohjen e gradës shkencore apo titullit akademik.”.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe komisionet *ad hoc*.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
Evis Kushi